



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës  
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

---

## **BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE**

**Shkurt, 2026**

## PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Numri i rasteve dhe vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse gjatë muajit shkurt 2026
2. Sëmundjet ngjitëse të raportuara në Kosovë, forma e agreguar dhe individuale
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

### QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

### 1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT SHKURT 2026

Gjatë muajit shkurt 2026 janë raportuar 10,768 raste me sëmundje ngjitëse Inc.(671.94 raste /100, 000 banorë). Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 (28,516 raste apo Inc 1600.12 raste/100,000). Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: Influenca sezonale (ILI) me 5,750 raste ose Inc. 358.81/100,000, Diare ac. me 3,460 raste ose Inc. 215.91/100,000 banorë dhe ARI/ITPR me 864 raste ose 53.92 në 100,000 banorë (Tab.1).

Gjatë muajit shkurt 2026 janë raportuar 14 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 6 raste me Bronchopneumoni me diagnozë përcjellëse, 4 raste me dg. Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse, 1 rast me diagnozë Meningitis acuta me diagnozë përcjellëse, 1 rast me dg. Meningoencephalitis acuta me diagnozë përcjellëse, 1 rast me Meningoencephalitis purulenta me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me Meningoencephalitis TBC me diagnozë përcjellëse.

**Tabela 1. Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/ shkaktarëve të raportuara në Kosovë, shkurt 2026 krahasuar me shkurt 2025**

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve/shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë shkurt 2026 krahasuar me shkurt 2025				
Sëmundjet /shkaktarët e sëmundjeve ngjitëse	Shkurt, 2026		Shkurt, 2025	
	Nr.	Incidenca/100,000	Nr.	Incidenca/100,000
COVID-19	0	0.00	6	0.34
ITPR - Pneumonia/ARI	864	53.92	1104	61.95
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	35	2.18	11	0.62
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	5750	358.81	22449	1259.68
Influenca A	4	0.25	72	4.04
Influenca B	0	0.00	215	12.06
RSV	32	2.00	35	1.96
Diarea acute	3460	215.91	4094	229.73
Variçela	356	22.22	331	18.57
Sindromi meningjeal	19	1.19	10	0.56
Helmimet me ushqim	66	4.12	14	0.79
Salmonella enteritidis	4	0.25	1	0.06
Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale me Rotavirus	17	1.06	4	0.22
E. Coli	2	0.12		0.00
Gastroenterokolitet	26	1.62	48	2.69
Hepatiti akut B	3	0.19	2	0.11
Morbilli		0.00		0.00
Parotiti epidemik		0.00	1	0.06
Pertussis		0.00	5	0.28
Rubella		0.00		0.00
TB	47	2.93	24	1.35
Tularemia	2	0.12	1	0.06
Brucelosis		0.00	2	0.11
Echinococcus		0.00		0.00
Leishmaniazë		0.00		0.00
Sëmundja Lyme		0.00		0.00
HIV	3	0.19	3	0.17
IST	17	1.06	20	1.12
Infeksionet streptokoksike të gr. A	38	2.37	11	0.62
Giardiaza	9	0.56	4	0.22
*Sëmundjet tjera ngjitëse	14	0.87	49	2.75
<b>Gjithsej</b>	<b>10768</b>	<b>671.94</b>	<b>28516</b>	<b>1600.12</b>
<b>*Sëmundjet tjera ngjitëse: Scarlatina, Herpes zoster, Erysipella, Mykozat, Mononucleoza</b>				

## 1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, SHKURT 2026

### Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar

**Influenca sezonale /ILI:** Gjatë muajit shkurt 2026 në IKShPK janë raportuar 5,750 raste me ILI (Inc. 358.81/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet një ulje prej 74.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (22,449 raste të raportuara). Gjithashtu krahasuar me muajin paraprak, janar 2026 me (14,500 raste të raportuara me ILI) vërehet një ulje prej 60.3%. Megjithatë, pavarësisht rënies, numri i rasteve të raportuara i atribuohet faktorëve si qarkullimit të viruseve respiratore, përfshirë virusin e gripit dhe viruseve tjera respiratore.

**Diarea akute:** Gjatë muajit shkurt 2026 në IKShPK janë raportuar 3,460 raste me diare akute (Inc.215.91/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (4,094 raste), vërehet një ulje prej 15.5% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak janar 2026, me 4,504 raste të raportuara, rënie prej 23.2% e rasteve të raportuara. Numri i rasteve të raportuara me diare akute mbetet shqetësues për shëndetin publik, marrë prasysh ekspozimin e vazhdueshëm të popullatës ndaj patogjenëve të ndryshëm ushqimorë dhe atyre përmes ujit, veçanërisht kushtet e ruajtjes dhe përgatitjes së ushqimit.

**ARI/ITPR:** Gjatë muajit shkurt 2026 në IKShPK janë raportuar 864 raste me ARI (Inc.53.92/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,104 raste) vërehet një ulje prej 21.7% e rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak janar 2026 me (1,867 raste) vërehet ulje e numrit të rasteve për 53.7%. Numri i rasteve të raportuara lidhet kryesisht me sezonin e infeksioneve respiratore, temperaturat e ulëta si dhe rritjen e ekspozimit në ambiente të mbyllura, duke favorizuar përhapjen e patogjenëve respiratorë.

**Variçella:** Gjatë muajit shkurt 2026 në IKShPK janë raportuar 356 raste me Variçellë (Inc.22.22/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 me (331 raste) vërehet rritje prej 7.6% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak janar 2026 me 456 raste të raportuara, ulje prej 17.8% e numrit të rasteve të raportuara.

## **Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:**

### **Sëmundjet vaksinëparandaluese**

Gjatë muajit shkurt 2026, nga të gjitha mostrat e testuara si të dyshimta në Fruth, Pertussis dhe Parotit në laboratorin e Mikrobiologjisë -IKShPK, nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv.

### **Zoonozat dhe sëmundjet transmise**

Nga ky grup i sëmundjeve, gjatë muajit shkurt, 2026 nga Laboratori i Mikrobiologjisë, IKShPK janë raportuar 2 raste me Tularemi. Rastet pozitive me Tularemi sipas komunave : 1 rast nga komuna e Lipjanit dhe 1 rast nga komuna e Skënderajit. Rastet i takojnë grup-moshave: 40-49 vjeç (1 rast) dhe 30-39 vjeç (1 rast) dhe sipas gjinisë një i përket gjinisë femërore dhe një gjinisë mashkullore. Gjatë anketimit epidemiologjik të dy rasteve me tularemi, faktorë i mundshëm është rreziku i lidhur me brejtësit dhe mjedisin. Konsumimi i ushqimit dhe ekspozimi ndaj mjediseve potencialisht të kontaminuara konsiderohen si rrugë e përhapjes së infeksionit. Pas anketimit janë dhënë rekomandimet për masa parandaluese dhe të kontrollit si dhe është rekomanduar testimi i kontakteve të rasteve pozitive.

### **Sindroma meningjeale**

Gjatë muajit shkurt, janë raportuar gjithsej 19 raste me Sindromë Meningjeale (*Mb. 1.19/100,000 banorë*), prej tyre 16 raste me Meningjit acuta serosa, 1 rast me Meningjit purulent, 1 rast me Meningoencephalit akut dhe 1 rast me Meningoencephalit acut purulent. Numri i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraprak (shkurt, 2025), kur ishin raportuar 10 raste (*Inc. 0.78/100,000 banorë*).

Numri më i madh i rasteve të raportuara sipas komunave është regjistruar në Prishtinë dhe Drenas, me nga 3 raste secila. Nga 2 raste janë raportuar në komunat Gjakovë, Gjiilan, Malishevë dhe Vushtrri. Ndërsa nga 1 rast është raportuar në komunat Ferizaj, Prizren, Hani i Elezit, Klinë dhe Suharekë. Sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshës, gjatë kësaj periudhe numri më i madh i rasteve është raportuar në grup-moshën 0–9 vjeç, me 7 raste (36.8%). Pas kësaj vjen grup-mosha 10–19 vjeç dhe 60–69 vjeç, me nga 4 raste (21.1%) secila. 2 raste (10.5%) janë raportuar në grup-moshën 30–39 vjeç, ndërsa nga 1 rast (5.3%) është raportuar në grup-moshat 20–29 vjeç dhe 70–79 vjeç. Sa i përket shpërndarjes sipas gjinisë, 57.9% (11 raste) i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 42.1% (8 raste) i takojnë gjinisë mashkullore.

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK përmes sistemit MedLIS, si dhe në laboratorin mikrobiologjik të Klinikës Infektive, janë identifikuar disa shkaktarë viralë dhe bakterialë në lëngun cerebrospinal (LCS). Gjithsej janë raportuar 11 raste me izolime pozitive. Shkaktarët viralë të identifikuar janë: Human Herpes Virus 1 (HSV-1) me 1 rast, Human Herpes Virus 7 (HHV-7) me 4 raste, Epstein-Barr Virus (EBV) me 3 raste dhe Citomegalovirus (CMV) me 1 rast. Ndërsa nga shkaktarët bakterialë janë identifikuar: Neisseria meningitidis me 1 rast dhe Haemophilus influenzae me 1 rast. Nga rastet e raportuara gjatë muajit shkurt 2026, katër raste kanë përfunduar me vdekje. Rasti i parë i përket një pacienti 4-vjeçar, i gjinisë mashkullore, nga komuna e Pejës, i hospitalizuar në repartin e Pediatriisë me diagnozë Meningitis acuta. Mostra e analizuar përmes sistemit MedLIS ka rezultuar pozitive për HHV-6. Rasti i dytë i përket një pacienti 62-vjeçar, i gjinisë mashkullore, nga komuna e Prishtinës, i hospitalizuar në repartin intensiv me diagnozë Meningoencephalitis TBC. Rasti i tretë i përket një pacienti 67-vjeçar, i gjinisë mashkullore, nga komuna e Vushtrrisë, i hospitalizuar me diagnozë Meningoencephalitis acuta purulenta. Rasti i katërt i përket një pacienteje 72-vjeçare, e gjinisë femërore, nga komuna e Gjakovës, e hospitalizuar në repartin intensiv me diagnozë Meningoencephalitis acuta.

### **Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim**

Gjatë muajit shkurt 2026, përmes SMSN nga të gjitha institucionet shëndetësore janë raportuar gjithsej 1,005 raste të sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim, prej të cilave: 1,054 raste me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (A09); 22 raste me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecifikuar (A04.8) ; 46 raste me dg. Intoksikacionet tjera bakteriale alimentare – (A05); 3 raste me dg. Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale (A04.9); 6 raste me dg. Giardiasis (Giardia lamblia) (A07.1). Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë

në IKSHPK dhe Kl. Infektive janë raportuar 16 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 9 raste Prishtinë, 3 raste Gjakovë, 2 raste Fushë Kosovë dhe 2 raste Mitrovicë. Sipas grup-moshave: 15 raste janë të grup-moshës 0-9 vjeç dhe 1 rast i grup-moshës 10-19 vjeç. Sipas gjinisë 9 raste janë të gjinisë femërore dhe 7 raste të gjinisë mashkullore; Rastet e konfirmuara me Giardia lamblia, sipas komunave janë: 3 raste Prizren, 2 rast Pejë dhe 1 rast Ferizaj. Sipas grup-moshave: 3 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç, 2 raste të grup-moshës mbi 65 vjeç dhe 1 rast i grup-moshës 10-19vjeç dhe sipas gjinisë 4 raste të gjinisë mashkullore dhe 2 raste të gjinisë femërore; rasti me Adenovirus, nga komuna e Prishtinës, i takon gjinisë femërore dhe grup-moshës 0-9 vjeç; Nga 4 rastet e raportuara me Salmonella enteridis, 3 prej tyre janë nga komuna e Prishtinës dhe 1 rast nga komuna e Vushtrrisë. Sipas grup-moshës: 2 raste i përkasin grup-moshës 0-9 vjeç, dhe 2 raste i përkasin grup-moshës 10-19 vjeç. Sipas gjinisë 3 raste janë të gjinisë mashkullore dhe 1 rast i gjinisë femërore.

## **Sëmundjet/Infeksionet respiratore**

Gjatë muajit shkurt 2026, janë testuar gjithsej 295 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator dhe SARS-CoV-2, të përzgjedhura nga qendrat sentinel. Nga mostrat 295 mostrat e testuara janë konfirmuar 4 raste me Influcencën A pozitivitet prej 1.36%. Sipas tipit: Të gjitha rastet pozitive janë me Influcencë A (4 raste). Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 32 (10.85%) mostra pozitive me RSV, 42 (14.24%) mostra pozitive në Human Rhinovirus, 26 (8.81%) mostra pozitive në Human Adenovirus, 3 (1.02%) mostra pozitive në Metapneumovirus dhe 1 (0.34%) mostër pozitive në Human parainfluenza virus. Gjatë kësaj periudhës nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv me SARS-CoV-2 (COVID-19). Nga 4 raste të raportuara/konfirmuara me Influcencë A, asnjë nuk është vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Intensiteti i influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për muajin shkurt 2026 paraqet aktivitet të ulët të qarkullimit. Krahasuar me muajin paraprak (janar 2026), vërehet rënie e ndjeshme e numrit të rasteve pozitive, pavarësisht se numri i testimeve mbetet i konsiderueshëm. Rastet pozitive të konfirmuara me Influcencë A i përkasin komunave: Fushë Kosovë, Lipjan, Rahovec dhe Suharekë, me nga një rast të raportuar në secilën komunë. Sipas grup-moshës, me Influcencë A: 2 raste i përkasin grup-moshës 65+ vjeç, ndërsa me nga një rast janë grup-moshat 0-4 vjeç dhe 35-50 vjeç. Rastet pozitive me virusin sincicial respirator (RSV) sipas komunave: Prishtinë dhe Malishevë (nga 5 raste), Ferizaj dhe Fushë Kosovë (nga 4 raste), Podujevë dhe Vushtrri (nga 3 raste), Drenas dhe Suharekë (nga 2 raste), ndërsa me nga një rast janë raportuar nga: Gjilani, Lipjani, Obiliqi dhe Shtimja. Sipas grup-moshës, shumica e rasteve i përkasin grup-moshës 0-4 vjeç (27 raste), ndërsa 2 raste i përkasin grup-moshës 51-64 vjeç, 1 rast grup-moshës 5-14 vjeç dhe 2 raste grup-moshës 65+ vjeç.

Gjatë muajit shkurt 2026 në IKSHPK janë raportuar 35 raste me SARI (Inc.1.96/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 me (11 raste) vërehet rritje e ndjeshme e numrit të rasteve dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak (60 raste), vërehet një rënie prej 41.7% e numrit të rasteve.

Të gjitha rastet, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Prej tyre rezultuan, 1 mostër pozitive në Influcencë A, 17 mostra pozitive në Virusin Sincicial (RSV), 6 mostra pozitive në Human Rhinovirus dhe 3 mostra pozitive në Human Adenovirus.

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (7 raste), Fushë Kosovë (6 raste), Malishevë (4 raste), Drenas (3 raste), Podujevë (3 raste), Vushtrri (3 raste), Ferizaj (2 raste), Obiliq (2 raste), Shtime (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Gjilan, Rahovec dhe Suharekë. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : 0-4 vjeç (15 raste), mbi 65 vjeç (10 raste), 51-64 vjeç (5 raste), 5-14 vjeç (3 raste) dhe 35-50 vjeç (2 raste). Sipas gjinisë, 18 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 17 gjinisë femërore. Nga të gjitha rastet SARI, 5 prej tyre ishin të vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal.

Gjatë muajit shkurt 2026, janë raportuar 4 raste të vdekjes nga SARI (CFR= 11.4%). Rastet e vdekjes nga SARI i takojnë grup-moshës 65+ (2 raste) dhe 51-64 vjeç (2 raste) dhe i përkasin komunave : Drenas, Vushtrri, Fushë Kosovë dhe Malishevë, me sëmundje përcjellëse dhe nuk janë të vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Nga të gjitha rastet e raportuara SARI,

në Klinikën Infektive u hospitalizuan 18 raste, ndërsa në Klinikën e Pediatriisë 16 raste (2 raste nga Reparti i Neonatologjisë) dhe 1 rast në Klinikën e Neurologjisë, ku 4 prej tyre u pranuan në Njësinë e Mjekimit Intensiv.

### **Ecuria me Tuberkuloz**

Në SMSN, gjatë muajit janar 2026, janë raportuar 47 raste me Tuberkuloz apo 2.93 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtinë dhe Gjakovë me nga (8 raste), Vushtrri (4 raste), me nga (3 raste) komunat: Pejë, Lipjan, Obiliq dhe Viti, me nga 2 raste komunat: Gjilan Drenas, Shtime, Rahovec dhe Skenderaj, me nga 1 rast: Mitrovicë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Deçan dhe Istog. Prej 47 rasteve të raportuara, 33 (70%) janë raste pulmonare dhe forma ekstra- pulmonare 14 (30%). Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht janë 19 raste (57%). Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezultoi se grup- mosha më e prekur është ajo mbi 70 vjeç (12 raste), grup-mosha 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç me nga (8 raste), 30-39 vjeç (6 raste), 20-29 vjeç dhe 40-49 vjeç me nga (5 raste) kurse grup mosha 15-19 vjeç (3 raste). Sipas gjinisë, rezultoi se gjinia mashkullore me 60% (28 raste) kurse 40% (19 raste) i takojnë gjinisë femërore.

### **Rastet me HIV/AIDS/IST**

Gjatë muajit shkurt 2026, janë raportuar 3 raste me HIV/AIDS, rastet janë të gjinisë mashkullore nga komuna Prishtinë, Prizren dhe një rast i huaj me kombësi gjermane por tani jeton në Kosovë/Prishtinë. Dy raste i takojnë grup moshës 15-24 vjeç dhe një rast 45-54.

### **Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST)**

Gjatë muajit shkurt 2026 janë raportuar gjithsej 17 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj (5 raste), Pejë (3 raste), Fushë Kosovë (2 raste), Kaçanik (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Prishtinë, Gjilan, Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Sipas diagnozës: Chlamydia 6 raste dhe Condyloma 11. Sipas gjinisë: 12 raste (71%) i takojnë gjinisë femërore dhe 5 raste (28%) gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës: 15-24 vjeç 9 raste (53%), 25-49 vjeç 8 raste (47%).

### **Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C**

Gjatë muajit shkurt 2026 janë raportuar tri raste me Hepatit akut B në observim (In Obs) dhe një rast me Hepatit B. Një rast është nga komuna e Klinës, i gjinisë femërore (59 vjeç), një rast është nga komuna e Mitrovicës, i gjinisë mashkullore (55 vjeç) dhe rasti tjetër është nga komuna e Gjilanit, i gjinisë mashkullore (43 vjeç).

Gjatë muajit shkurt 2026 nuk është raportuar asnjë rast me Hepatit akut C.

## Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, shkurt 2026

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, shkurt 2026																									
SËMUNDJA/SHKAKTARI	Pneumonia/ ARI	SARI	ILI	Sindroma diareale	Variçella	Influc a A	RSV	Sindroma meningjeale				Hepatit ac. B	Helmim t me ushqim	Gastroen terokolit et	Tularemi	Salmonel loza	E.coli	Infeksi net virale dhe infeksi et tjera specifike	IST	HIV	TB	Giardia a	Infeksi net streptok oksike të gr. A	Sëm.tjer a ngjitëse	Totali
								Meningji serosa	Meningji t purulent	Meningo encephal it ac.	Meningo encephal itis purulent a														
DEÇAN	19	0	114	63	7																1	3	2		209
DRAGASH	9		73	16	6																				104
DRENAS	16	3	48	65	20		2	3												2					159
F. KOSOVË	5	6	91	91	6	1	4					1	2				2	2		1					212
FERIZAJ	32	2	433	206	24		4	1				1	7					5		1	1				717
GJAKOVË	18	0	191	77	37			1		1		4	1				3			8		32			374
GJILAN	7	1	227	131	8		1	2										1		2					380
GRAÇANICË																									0
H. I ELEZIT	5		45	13	4			1																	68
ISTOG	7	0	67	29	4							2	1							1			1		112
JUNIK	0	0	14	1	2																	1			18
KAÇANIK	5		61	35	4									1				2				1			109
KAMENICË	0		302	74																					376
KLINË	38	0	222	84	18			1			1	1						1					1		367
KLLOKOT																									0
LEPOSAVIQ																									0
LIPJAN	0		84		14	1	1							1						3					104
MALISHEVË	0	4	70	35	6		5	2				1						1							124
MAMUSHË	1		17	25	7																				50
MITROVICË	49	0	430	319	29						1	2					2			1			10		843
MITROVICË E VERIUT																									0
N. BËRDË			23	10																					33
OBILIQ	0	2	64	45	11		1					1	1							3					128
PARTESH																									0
PEJË	33	0	786	297	23							20	1					3		3	2		2		1170
PODUJEVË	3	3	151	144	16		3						1												321
PRISHTINË	589	7	749	725	47		5	3				9	7		3		10	1	2	8		2			2167
PRIZREN	4		425	347	24			1				2							1		3				807
RAHOVEC	1	1	47	32	2	1												1		2					87
RANILUG																									0
SHTËRPCE	1																								1
SHTIME	7	2	300	63	2		1						3				2			2					382
SKËNDERAJ	1	0	80	64	4							1		1						2					153
SUHAREKË	5	1	517	397	16	1	2	1																	940
VITI			100	46	7															3					156
VUSHTRRI	9	3	19	26	8		3		1		1	20	1		1					4					96
Z. POTOK																									0
ZVEÇAN																									0
BURGU I LIPJANIT																									0
PA ADRESË												1													1
TOTALI	864	35	5750	3460	356	4	32	16	1	1	1	3	66	26	2	4	2	17	17	3	47	9	38	14	10768

\*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza



### **3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, SHKURT 2026**

Rastet e spitalizuara në numër më të madh nga sëmundjet ngjitëse janë raportuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respirator, të pasuara me diarë akute dhe gastroenterokolite. Vetëm një pjesë e këtyre rasteve kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit, ndërsa pjesa tjetër raportohet bazuar në diagnozën klinike (shih Tabela 3).

**Tabela 3. Rastet e spitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatrië dhe spitalet e përgjithshme, shkurt 2026**

<b>Sëmundja</b>	<b>Rastet</b>
Pneumonia /ARI	124
SARI	35
Sindroma meningjeale	19
Helmimet me ushqim	15
Diarea akute dhe gastroenterokolite	109
Status febrilis	15
Exanthema	1
Mononucleosis	1
Erysipela	1
<b>Total</b>	<b>320</b>

### **4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT SHKURT 2026**

#### **Epidemia kolektive në Mitrovicë**

Epidemia kolektive në Mitrovicë ka filluar më datë 17.02.2026 dhe ka përfunduar më 03.03.2026. Fillimisht më datë 17.02.2026 rreth orës 20:00, njoftohet QRShP Mirovicë nga Emergjencia e Spitalit Rajonal "Sami Haxhibeqiri", për një dyshim në helmim me ushqim. Dy familje nga Mitrovica e Jugut, Lagje e Re, janë bashkuar në një ndejë familjare gjithsej 17 persona. Embëlsirë-Trileqe të cilën e kanë pregaditur vetë në mëngjes të së njejtës ditë më 17.02.2026. Embëlsirën e kanë konsumuar rreth orës 17:00 dhe pas 2 ore e gjysme kanë pasur ankesa 5 antarë të familjes "N.N", si dhembje barku, vjellje e barkqitje, pastaj ankesa të njejtës kanë pasur edhe personat e tjerë që e kanë konsumuar ëmbëlsirën. Prej 17 personave sa e kanë konsumuar ëmbëlsirën 16 persona kanë pasur ankesa dhe 5 prej tyre janë hospitalizuar. Pas trajtimit të gjithë janë liruar nga spitali dhe gjendja e tyre shëndetësore është përmirësuar.

Masat e ndermarra: Anketa epidemiologjike, lajmërimi i rastit te inspektoriati sanitar rajonal, hulumtimi i rasteve te reja dhe marrja e dy mostrave të fecesit në koprokulturë ku nuk është izoluar asnjë patogjen.. Mostra e ëmbëlsirës nuk është marrë pasi që e kanë konsumuar të tërën.

## 5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre. Komunat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok, komuna këto që gjithashtu nuk raportojnë as me kopje fizike.

**Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, shkurt 2026**

KOMUNA	KOPJE FIZIKE										SMSN											
	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucio net Private	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucio net Private	QKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	
DEÇAN							115				115							48				48
DRAGASH							99				99							4				4
DRENAS							85				85						34	2				36
F. KOSOVË											0						75	16	102			193
FERIZAJ	11					127	81	202			421	1				17	59	91				168
GJAKOVË											0	48				50	265	70				433
GJILAN	6					122	64	176	9		377	12				48	23	49				132
GRAÇANICË											0											0
H. I ELEZIT							60				60						6					6
ISTOG							19	42			61						30	1				31
JUNIK							8				8						13					13
KAÇANIK							66				66						38					38
KAMENICË							133	243			376						52	21				73
KLINË							305	29			334						1					1
KLLOKOT											0											0
LEPOSAVIQ											0											0
LIPJAN											0						81	11	10			102
MALISHEVË											0						106	7				113
MAMUSHË							42				42						35					35
MITROVICË	314						350	141	8		813				1		28					29
MITROVICË V.											0											0
N. BËRDË							33				33						2					2
OBILIQ											0						73	41	6			120
PARTESH											0											0
PEJË	24					5	218	673	148		1068	126				2	36					164
PODUJEVË							234	9	23		266						40	12	2			54
PRISHTINË		105	124				123	498	266		1116		66	13	12	6	13	2	19	917	3	1051
PRIZREN	28	64		1	5	15	126	169	83		491	24	11		3	19	112	147				316
RAHOVEC											0						45	24	9			78
RANILLUG											0											0
SHTËRPCE											0											0
SHTIME							57	201			258						64					64
SKËNDERAJ							64	50			114						38					38
SUHAREKË						41	368	322	56		787				2	126	5					133
VITI							83	71			154						40	25				65
VUSHTRRI	9										9	31					6	37	1			75
Z. POTOK											0											0
ZVEÇAN											0											0
Gjithsej	392	169	124	1	5	310	2733	2826	593	7153	218	90	24	12	9	152	2	1499	1476	133	3615	

Gjatë muajit shkurt 2026, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) janë raportuar gjithsej 3,615 raste me sëmundje ngjitëse dhe krahasuar me numrin e përgjithshëm të rasteve të raportuara (10,678) i shprehur në përqindje (33.57% ). Gjatë muajit shkurt 2026 vërehet një tendencë në rritje prej 12.59% e numrit të rasteve të raportuara përmes SMSN krahasuar me muajin paraprak, janar 2026. (Tabela 4).

## **6. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, SHKURT 2026**

### **Kolera**

Situata epidemiologjike e kolerës vazhdon të monitorohet në nivel global. Përkufizimet e rasteve, strategjitë e testimit dhe sistemet e mbikëqyrjes ndryshojnë ndërmjet vendeve, ndërsa plotësia e të dhënave dhe niveli i nën-raportimit mund të variojnë, prandaj interpretimi i të dhënave duhet të bëhet me kujdes. Nga 28 janari 2026 deri më 25 shkurt 2026, në nivel global janë raportuar 24 009 raste të reja të kolerës, përfshirë 275 vdekje. Rastet janë raportuar nga disa vende të Azisë dhe Afrikës, përfshirë Afganistanin, Angolën, Burundin, Republikën Demokratike të Kongos, Malauin, Mozambikun, Mianmarin, Namibinë, Nigerinë, Pakistanin, Somalinë, Sudanin, Jemenin, Zambian dhe Zimbabven. Numri më i madh i rasteve është raportuar në Afganistan (9 460 raste) dhe në Republikën Demokratike të Kongos (9 325 raste), ndërsa këto dy vende kanë raportuar gjithashtu një pjesë të konsiderueshme të vdekjeve të lidhura me sëmundjen. Vdekje të reja janë raportuar edhe në Mozambik, Zambin, Angolë, Nigeri dhe Jemen. Në periudhën e mëparshme raportuese (24 dhjetor 2025 – 28 janar 2026) në nivel global janë raportuar 11 965 raste të reja, përfshirë 126 vdekje, ndërsa 735 raste shtesë janë raportuar në mënyrë retrospektive për periudha të mëhershme. Që nga 1 janari 2026 deri më 25 shkurt 2026, globalisht janë raportuar gjithsej 25 714 raste të kolerës, përfshirë 282 vdekje, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2025 janë raportuar 69 088 raste dhe 709 vdekje, duke treguar një numër më të ulët të rasteve të raportuara në fillim të vitit 2026 krahasuar me vitin paraprak. Sipas vlerësimit të ECDC, rastet e kolerës vazhdojnë të raportohen në disa vende të Afrikës, Azisë, Lindjes së Mesme dhe Amerikës, ndërsa për udhëtarët që vizitojnë këto vende rreziku i infektimit konsiderohet i ulët. Megjithatë, importimi sporadik i rasteve në vendet e BE/ZEE mbetet i mundshëm, duke qenë se shumica e rasteve të raportuara në këtë rajon lidhen me udhëtime në zona endemike. Në vitin 2024, tetë vende të BE/ZEE raportuan 16 raste të importuara, ndërsa në vitin 2023 u raportuan 12 raste dhe në vitin 2022 29 raste, të gjitha me histori udhëtimi në zona të prekura nga kolera. Për parandalimin e infeksionit rekomandohet zbatimi i masave të higjienës dhe sigurisë ushqimore, veçanërisht për udhëtarët në zona endemike. Këto masa përfshijnë konsumimin e ujit të sigurt ose të trajtuar, larjen e rregullt të duarve me sapun, konsumimin e ushqimeve të gatuar mirë dhe shmangien e produkteve të papërpunuara të detit. Vaksinimi mund të merret në konsideratë për grupet me rrezik më të lartë të ekspozimit, si punonjësit e emergjencës dhe të ndihmës humanitare.

### **Monitorimi i grumbullimeve masive - lojërat olimpike dhe paraolimpike dimërore - Milano Cortina**

Lojërat Olimpike Dimërore Milano Cortina 2026 u zhvilluan nga 4 deri më 22 shkurt 2026 në disa lokacione në veri të Italisë, me pjesëmarrjen e mbi 2, 900 atletëve nga më shumë se 90 vende dhe një numër të madh spektatorësh. Sipas vlerësimit të ECDC, deri më 26 shkurt 2026 nuk janë identifikuar ngjarje madhore të shëndetit publik të lidhura me sëmundje ngjitëse gjatë zhvillimit të kësaj ngjarjeje masive. Janë raportuar vetëm disa shpërthime të kufizuara të sëmundjeve gastrointestinale dhe sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) mes atletëve në Fshatin Olimpik, ndërsa nuk është evidentuar transmetim i sëmundjeve ngjitëse i lidhur me pjesëmarrjen e spektatorëve në vendet e zhvillimit të garave. Lojërat Paraolimpike Dimërore do të zhvillohen nga 6 deri më 15 mars 2026, me pjesëmarrjen e mbi 600 atletëve, ndërsa monitorimi epidemiologjik i kësaj ngjarjeje vazhdon. Sipas vlerësimit të ECDC, rreziku për qytetarët e BE/ZEE për t'u infektuar me sëmundje ngjitëse gjatë këtyre ngjarjeve konsiderohet i ulët, nëse respektohen masat parandaluese si vaksinimi sipas kalendarit kombëtar, higjiena e duarve dhe ushqimit, etika respiratore dhe vetë-izolimi në rast të simptomave respiratore.

### **Chikungunya**

Që nga nëntori 2025, më shumë se 70 raste të sëmundjes së virusit chikungunya janë raportuar në 10 vende të BE/ZEE tek udhëtarët që janë kthyer nga Seychelles. Ky numër paraqet një rritje të dukshme krahasuar me muajt e mëparshëm të vitit 2025, ndërsa në vitet e kaluara nuk janë raportuar raste të tilla të lidhura me udhëtimet nga ky vend. Shfaqja e chikungunya në Seychelles lidhet me përhapjen më të gjerë të virusit në rajonin e Oqeanit Indian, ku gjatë vitit 2025 është raportuar edhe një shpërthim i madh në Réunion Island. Sipas autoriteteve lokale shëndetësore, aktualisht virusi chikungunya është bërë më i përhapur në Seychelles krahasuar me arboviruset e tjera që qarkullojnë në vend. Sipas vlerësimit të European Centre for Disease Prevention and Control, probabiliteti i infektimit me virusin chikungunya për udhëtarët që vizitojnë Seychelles konsiderohet i lartë. Duke qenë se periudha me fluksin më të madh të udhëtimeve drejt këtij destinacioni është nga shkurti deri në prill, rekomandohet forcimi i komunikimit me udhëtarët dhe klinikat e mjekësisë së udhëtimit për rritjen e masave parandaluese. Në varësi të rekomandimeve kombëtare, mund të merret në konsideratë edhe vaksinimi i udhëtarëve. Megjithatë, sipas ECDC, mundësia e transmetimit të mëtejshëm të virusit në Evropën kontinentale pas importimit nga një

udhëtar i infektuar konsiderohet e ulët në këtë periudhë të vitit, pasi kushtet mjedisore aktualisht nuk janë të favorshme për aktivitetin e mushkonjave Aedes, të cilat janë vektori kryesor i transmetimit.

### **Influenca A(H1N1)**

Në shkurt 2026, autoritetet shëndetësore në Spanjë raportuan një rast të konfirmuar tek njeriu të virusit të gripit të derrit Influenca A(H1N1)v në rajonin autonom të Katalonisë. Rasti u konfirmua përmes testimit PCR dhe sekuencimit, ndërsa sipas informacionit aktual personi i infektuar nuk ka histori të njohur ekspozimi ndaj derrave ose ndaj një mjedisi të kontaminuar. Mostra u identifikua gjatë survejancës së infeksioneve akute respiratore dhe rasti mbetet asimptomatik, ndërkohë që hetimet epidemiologjike janë ende në vazhdim. Raste sporadike të gripit të derrit tek njerëzit janë raportuar herë pas here në Spanjë dhe në vende të tjera. Në Spanjë janë raportuar gjithsej katër raste të tilla në 17 vitet e fundit, pa evidencë të transmetimit nga njeriu te njeriu. Sipas vlerësimit të ECDC, raste sporadike të infeksioneve me viruse gripi me origjinë nga derrat janë raportuar globalisht dhe zakonisht lidhen me kontaktin me kafshë të infektuara. Transmetimi i kufizuar nga njeriu te njeriu është dokumentuar më parë, por mbetet një ngjarje e rrallë. Bazuar në informacionin aktual, probabiliteti i transmetimit të mëtejshëm tek njerëzit konsiderohet shumë i ulët. Megjithatë, viruset e reja të gripit tek njerëzit, përfshirë viruset zoonotike, duhet të karakterizohen dhe të ndahen me laboratorët referentë kombëtarë dhe me qendrat bashkëpunuese të OBSH-se. Të gjitha rastet duhet të ndiqen nga afër për të përjashtuar transmetimin nga njeriu te njeriu dhe për të zbatuar masat e kontrollit.

### **Influenca A(H10N3)**

Nga përditësimi i fundit është raportuar për një rast human me virusin e gripit të shpendëve Influenca A(H10N3) tek një mashkull 34-vjeçar nga Guangdong, në Kinë. Sipas raportimit të OBSH-së më 20 shkurt 2026, rasti ka zhvilluar simptoma më 29 dhjetor 2025, është hospitalizuar dhe aktualisht ndodhet në gjendje stabile. Para shfaqjes së simptomave është raportuar ekspozim ndaj shpendëve të gjallë. Ky është rasti i tretë i raportuar gjatë vitit 2025. Që nga viti 2021 dhe deri më 20 shkurt 2026, në nivel global janë raportuar gjithsej shtatë raste njerëzore të infeksionit me virusin A(H10N3), të gjitha në Kinë dhe pa raste vdekjeje. Shumica e rasteve kanë qenë me infeksione të rënda dhe kanë pasur histori kontakti me kafshë të gjalla ose me mjedise të kontaminuara. Sipas vlerësimit të ECDC-së, deri më tani janë vërejtur vetëm raste sporadike tek njerëzit dhe nuk është dokumentuar transmetim nga njeriu te njeriu. Për këtë arsye, rreziku për shëndetin publik në BE/ZEE konsiderohet shumë i ulët. Burimi më i mundshëm i infektimit mbetet kontakti i drejtpërdrejtë me shpendë të infektuar ose me mjedise të kontaminuara. ECDC vazhdon të monitorojë situatën përmes aktiviteteve të inteligjencës epidemiologjike dhe survejancës së gripit, në bashkëpunim me EFSA dhe laboratorin referent të BE-së për gripin e shpendëve. Për situatën publikohen gjithashtu raporte periodike mbi gripin e shpendëve.

### **Fruthi**

Që nga marsi i vitit 2025, rastet e fruthit në vendet e EU/ZEE kanë shënuar një ulje të përgjithshme, duke ndjekur sezonin e zakonshëm të sëmundjes me rënie gjatë muajve të verës. Në dhjetor 2025, 28 vende raportuan të dhëna për fruthin, me 97 raste të konfirmuara nga 11 vende dhe 17 vende pa raste. Për periudhën 1 janar–31 dhjetor 2025, janë raportuar gjithsej 7 655 raste, 75% e të cilave ishin të konfirmuara laboratorikisht dhe 40% e rasteve ishin tek fëmijët nën pesë vjeç ndërsa 34,9% tek individët mbi 15 vjeç. Rastet më të larta të njoftimit janë regjistruar tek foshnjat nën një vjeç dhe fëmijët një deri katër vjeç. Nga rastet me informacion për vaksinimin, 79,9% ishin të pavaksinuar, 10,3% kishin marrë një dozë dhe 7,9% kishin marrë dy ose më shumë doza. Gjatë periudhës raportuese u regjistruan tetë vdekje të lidhura me fruthin. Përmes mbikëqyrjes së inteligjencës epidemike janë identifikuar shpërthime në Francë dhe Spanjë dhe janë raportuar raste sporadike dhe klasterë në vende të tjera të EU/ZEE. Jashtë EU/ZEE, Anglia raportoi 96 raste të konfirmuara laboratorikisht, kryesisht tek fëmijët nën 10 vjeç, Izraeli raportoi 988 hospitalizime dhe 14 vdekje, Ukraina 1 502 raste, ndërsa Afrikë CDC raportoi shpërthime në Mozambik dhe Liberi. Në rajonin e Amerikës, 1 031 raste dhe asnjë vdekje u raportuan në 2026 duke shënuar një rritje të madhe krahasuar me vitin 2025. ECDC vlerëson se, edhe pse shumica e rasteve të fundit janë rezultat i transmetimit lokal ose komunitar, rastet e lidhura me udhëtimet vazhdojnë të raportohen dhe vigjilenca mbetet e domosdoshme për shkak të mbulimit të pamjaftueshëm të vaksinimit, rritjes së lëvizjeve gjatë periudhave të pushimeve dhe mundësisë së importimit të rasteve. Masat e rekomanduara përfshijnë përbushjen e boshllëqeve të imunitetit përmes vaksinimit të plotë sipas skemave kombëtare, përmirësimin e mbikëqyrjes dhe kapaciteteve të shëndetit publik për zbulimin dhe kontrollin e shpërthimeve, rritjen e vetëdijes klinike të profesionistëve të shëndetit, sigurimin e vaksinimit të plotë të profesionistëve dhe promovimin e pranimit të vaksinave përmes komunikimit të rrezikut dhe angazhimit të komunitetit, duke adresuar barrierat dhe duke ofruar mbështetje për popullatat e pazhvilluara ose të izoluara nga shërbimet shëndetësore. Gjithashtu, udhëtarët duhet të kontrollojnë statusin e vaksinimit dhe të konsultohen me mjekun para udhëtimeve. ECDC vazhdon të monitorojë situatën dhe të përditësojë rekomandimet për përgjigje të shëndetit publik.

## **7. REKOMANDIMET**

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

---

**INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË**

**PUBLIKE TË KOSOVËS**

**Departamenti i Epidemiologjisë**

**Adresa: R. Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000**

**WebFaqe: <http://www.ikshpk.rks-gov.net>**

**E-mail: [QOE.IKSHP@rks-gov.net](mailto:QOE.IKSHP@rks-gov.net)**

**Telefoni+38338 541432**

---

